Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/492
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **Riakreditohet** "Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës"- (SHKÇAK), me adresë Rr. "Sylejman Vokshi" nr.14 - Prishtinë, 10000 Kosova, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 31.03.2020 deri 31.03.2024, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Teknik i Kontabilitetit,** Niveli IV sipas KKK, me 52 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për një grup është maksimumi 50 kandidatë dhe ky institucion ka të drejtë të ketë katër grupe brenda një cikli të trajnimit.

2. **Kontabilist i Certifikuar,** Niveli V sipas KKK, me 52 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për një grup është maksimumi 50 kandidatë dhe ky institucion ka të drejtë të ketë dy grupe brenda një cikli të trajnimit.

3. **Auditor i Certifikuar,** Niveli V sipas KKK, me 92 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për një grup është maksimumi 50 kandidatë dhe ky institucion ka të drejtë të ketë dy grupe brenda një cikli të trajnimit.

4. **Auditor i Brendshëm i Certifikuar,** Niveli V sipas KKK, me 85 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për një grup është maksimumi 50 kandidatë dhe ky institucion ka të drejtë të ketë dy grupe brenda një cikli të trajnimit.

5. **Auditor i Certifikuar në Sektorin Publik,** Niveli V sipas KKK, me 98 kredi të AAP. Numri i kandidatëve për një grup është maksimumi 50 kandidatë dhe ky institucion ka të drejtë të ketë dy grupe brenda një cikli të trajnimit.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës" për riakreditim, dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, u vendos si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës" - (SHKÇAK);
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK